



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 81- Mars- 2010 ZYRA PËR INFORMIM - www.malisheva-komuna.org





Përmbajtja

Këtë fundjavë shënohen “Epopeja e UÇK”-së dhe Dita e Mësuesit.....	3
Në vitin e gjashtë me radhë komuna mbështet Handikos-in në Malishevë.....	3
Përcaktohen tre emrat e stafit menaxhues të Qendrës së Kompetencës	4
Mbahet mbledhja e parë e KKSBB-së	4
Miratoen ndryshimet e tri rregulloreve komunale	5
Shënohet Dita e Mësuesit, ndahen shpërblime të ndryshme	6
Akademi, nderime dhe homazhe për dëshmorët e kombit	7
Shënimi i Epopesë, ka qenë dinjitoz dhe i organizuar mirë	9
Shënohet Dita e Gruas	10
Kryetari Kilaj njihet me problemet e gjimnazistëve	10
Komuna nënshkroi memorandumin për mbrojtjen e fëmijëve në punë	11
Si çdo të enjte Kilaj ka vazhduar me pritjen e palëve	12
Të përgatitet raporti vjetor financiar	12
Kryetari Kilaj ka vazhduar takimet me qytetar	13
U mbajt mbledhja e dytë e KPF-së.....	13
Nuk do të lejohen ndërtimet pa leje në Malishevë	14
Kompletohet stafi i Qendrës së Kompetencës	14
Nënshkruajnë marrëveshjen për ndërtimin e ujësjellësit për fshatrat Turjakë e Burim	15
Miratoen të gjitha pikat e rendit të ditës	16
Prilli do të jetë muaj i aksionit për mbrojtje të ambientit	17
Ndërrohet komanda LMT-së në Malishevë	17
Përkujtohen dhe nderohen martirët e “Masakrës së Burimit”	18
Katër çështje u rekomanduan për kuvend.....	19



Këtë fundjavë shënohen “Epopeja e UÇK”-së dhe Dita e Mësuesit

Malishevë, 1 mars

Duke filluar nga e dita e premte, përmes aktiviteteve të ndryshme, do të shënohen dy data të rëndësishme të historisë sonë, “Epopeja e UÇK”-së dhe Dita e Mësuesit, për të cilat, nga ana e komunës do të ketë disa organizime, kështu u bë e ditur sot në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve.

Të premten, me 5 mars, për nderë të Ditës së Mësuesit, do të mbahen garat tradicionale të recitimit, ndërsa pas kësaj edhe takimi tradicional me veteranët e arsimit, ku do të ndahen mirënjohje për kontributin në arsimin e Malishevës.

Ndërsa të shtunën, me 6 mars, është planifikuar një Akademi, për nder të Ditës së Dëshmorëve të Kosovës, ditë e cila shënohet në kuadër të shënimeve të 5,6 dhe 7 marsit, Epopeja e UÇK-së, dhe sakrifica e familjes së Komandantit Legjendar të UÇK-së, Adem Jasharit dhe pas kësaj akademie, do të bëhen nderimet në varrezat e dëshmorëve në Prekaz, Malishevë dhe Kleçkë.

Në këtë mbledhje të Këshillit të Drejtorëve, kryetari i komunës, z.Isni Kilaj, kërkoi nga shërbimet publike, të shqyrtohet mundësia e pastrimit të Liqenit Mirusha, pas vërshimeve të fundit si dhe rregullimi i parkut të qytetit.

Në vitin e gjashtë me radhë komuna mbështet Handikos-in në Malishevë

Malishevë, 1 mars

Edhe në vitin e gjashtë të radhës, Komuna e Malishevës, do ta përkrah organizatën e Handikos-it në Malishevë. Kjo është konfirmuar sot, pasi kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, ka nënshkruar marrëveshjen me Handikosin, përkatësisht me menaxheren e HANDIKOS-it, zonjën Ferida Hoxha, për përkrahjen e kësaj të fundit, rreth 6 000 euro.

Menaxherja e Handikos-it në Malishevë, Feride Hoxha e ka theksuar se “ky është viti i gjashtë me radhë që komuna na mbështet në punën tonë dhe iu del në ndihmë rreth 700 personave me aftësi të kufizuara, sa janë në Malishevë”.

Sipas saj, buxheti i kësaj organizate për mbulimin e aktiviteteve me personat me aftësi të kufizuara është 14 722 euro, për një vit, ku përveç komunës, edhe “Save the Children”, e përkrah me një shumë prej 3906 eurove, brenda vitit.

“Unë kam qenë dhe jam, që në mënyrë institucionale, të përkrahim këtë shtresë të shoqërisë sonë”, është shprehur kryetari i komunës, z. Isni Kilaj.

Përcaktohen tre emrat e stafit menaxhues të Qendrës së Kompetencës

Malishevë, 1 mars



Pas mbajtjes së intervistave, në zyrat e drejtorisë komunale për arsim, në prani të përfaqësuesve të MASHT-it, komisioni intervistues është përcaktuar për tre emrat e stafit menaxhues të Qendrës së Kompetencës në Malishevë.

Ky komision ka vendosur që në mesin e katër konkurrentëve për udhëheqjen e kësaj qendre të përzgjedhë Besim Dobruna, ndërsa dy zëvendësit e tij, të cilët kanë detyra të caktuara të menaxhimit, kanë Nazmi Zogaj dhe Besart Shala.

Qendra e Kompetencës, është një shkollë profesionale, me pesë drejtime, në administratë, ekonomi dhe teknologji informative, ndërsa studentët që dalin nga kjo shkollë, do të marrin diploma të njohura ndërkombëtarisht. Sipas përgjegjësve të arsimit në Malishevë, të gjitha përgatitjet janë duke vazhduar sipas planeve dhe në ditët në vijim do të kompletohet edhe stafi mësimor dhe ai teknik në këtë shkollë.

Numri i tërësishëm i stafit, do të jetë 44 persona, duke përfshirë edhe menaxhmentin. Ndërtimi i kësaj shkolle do të kushtoj afër pesë milion euro, dhe në të njëjtën kohë është investimi më i madh i bërë në Malishevë. Financimi i ndërtimit të këtij objekti bëhet nga qeveria norvegjeze, si dhe nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

Mbahet mbledhja e parë e KKSB-së

Malishevë, 4 mars

Sot është mbajtur mbledhja e parë e Këshillit Komunal për Sigurinë në Bashkësi, të cilën e ka udhëhequr (me autorizim të kryetarit) drejtori i Drejtorisë për Emergjencë dhe Siguri, z. Halit Zogaj, ndërsa është diskutuar për gjendjen e sigurisë në komunën tonë dhe aspektet tjera që kanë të bëjnë me këtë fushë.



Fillimisht, shefi i kësaj drejtorie Ejup Zulfaj, ka paraqitur një raport të punës, ndërsa më pas, anëtarët e këshillit, kanë raportuar secili nga këndi i vet për çështjen e sigurisë në komunë, përderisa situata është vlerësuar stabile dhe qetë.

Sipas u.d. të komandantit të stacionit policor në Malishevë, Bekim Begaj, gjatë vitit 2009 ka rënie të vepra penale në territorin e Malishevës, në raport me vitin 2008, për 16%, përderisa në 75% të rasteve policia ka zbuluar kryerjet e

veprave penale, ndërsa situatë më shqetësuese, sipas policisë vazhdojnë të mbeten aksidentet në trafik dhe tentim vetëvrasjet.

Edhe kreu i Bashkësisë Islame në Malishevë, Xhevat Kryeziu, sikurse edhe anëtarët e tjerë të KKS-së, e vlerësuan komunën tonë, si një vend kryesisht të qetë, në veçanti për vrasjet, por edhe në aspektet tjera të sigurisë së përgjithshme, duke përjashtuar aksidentet dhe tentim vetëvrasjet, ndërsa shtruan nevojën që për këto dy dukuri të merren iniciativa për sensibilizim të opinionit.

Nga mbledhja e dytë e radhës së Kuvendit Komunal

Miratohen ndryshimet e tri rregulloreve komunale

Malishevë, 5 mars

Kuvendi Komunal, në mbledhjen e dytë të radhës së punës (për këtë vit), me propozim të drejtorive komunale dhe me rekomandim të KPF-së, ka bërë miratuar ndryshimin e tri rregulloreve, si dhe ka marrë vendimin për bartjen e mjeteve të mbetura nga buxheti i vitit 2009, në buxhetin e vitit 2010.

Rregulloret që u miratuan në seancën e sotme të KK-së, janë: Rregullorja për ngarkesa, tarifa dhe gjoba komunale, Rregullorja për leje komunale të punës së veprimtarive afariste, si dhe Rregullorja për kryerjen e transportit të udhëtarëve me autotaksi dhe kombitaksi.

Këto rregullore janë miratuar sipas propozimeve të drejtorive përkatëse dhe me ndryshimet e propozuara nga anëtarët e KK-së, të cilat janë përshtatur me ligjet e Republikës së Kosovës që janë në fuqi.

Në Malishevë

Shënohet Dita e Mësuesit, ndahen shpërblime të ndryshme

Malishevë, 5 mars

Përmes një manifestimi me karakter komunal, organizuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit është shënuar Dita e Mësuesit. Me këtë rast janë ndarë mirënjohje për recituesit më të mirë në gara tradicionale që mbahen për nder të kësaj dite, si dhe janë ndarë mirënjohje për mësuesit më të mirë, shkollat më aktive dhe për veteranët e arsimit.

“Shkronjat shqipe që ishin më rënda se plumbat, na e sollën 28 Nëntorin, na e sollën 17 Shkurtin dhe do na e sjellin bashkimin e kombit, përfundimisht në Evropën e popujve të bashkuar”, ka thënë mes tjerash Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, në fjalën e tij, me rastin e shënimit të Ditës së Mësuesit. “Sot fëmijët tanë rriten me ëndrra të bukura për ti realizuar në jetë, mësuesit kanë kushte më të mira, e shkollat po bëhen të bukura, ashtu siç kanë ëndërruar Rilindësit tanë”, tha kryetari Kilaj, duke çmuar lartë punën e rilindësve tanë dhe hapjen e shkollës së parë shqipe.



Një historik për rrugëtimin e gjuhës shqipe, e përshkroi drejtori i Drejtorisë së Arsimit, z. Isuf Morina.

Të shpërblyerit në lëminë e arsimit janë: në garat e recituesve-parashkollor: vendi i parë - Juvenilia Krasniqi, vendi i dytë- Floriant Begaj dhe i vendi i tretë - Altin Kryeziu. Për fillorist : I – Doruntina Gashi, II – Agnesa Telaku dhe III-Madona Morina. Programi i mesëm i ulët: I-Arlind Krasniqi, II-E.Hoti, III-Antigona Berisha.

Mësuesit më të dalluar që kanë dhënë kontribut disa vjeçar në shkollën shqipe në Malishevë: Sabrije Shurdhaj- mësim parashkollor, Milazim Morina-cikli i ulët, Islam Paçarizi-cikli lartë, Ismet Morina dhe Haki Kryeziu-cikli i mesëm. Shkollat më aktive, më e gjelbëruar dhe më të pastra, u shpërblyen: “Beqir Gashi”-Rrezor dhe “Afrim Buçaj”-Lladroc, si shkollat më aktive “Kajtaç Ramadani”-Kijevë dhe Dëshmorët e Kombit”-Guncat, për hapësirë të gjelbëruar, ndërsa shkolla e Lumishtës dhe ajo në Bellanicë, si shkollat më të mira në pastërti.

Në fund mirënjohje ju ndanë edhe 18 veteranëve të arsimit nga Malisheva.

Shënohet “Epopeja e UÇK-së”

Akademi, nderime dhe homazhe për dëshmorët e kombit

Malishevë, 6 mars



Në Malishevë, me aktivitete të ndryshme, po shënohet Epopeja e Lavdishme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndërsa sot, në ditën e dëshmorëve të kombit, nën përkujdesjen e Kryetarit të Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, u mbajt një Akademi, si dhe janë bërë nderime dhe homazhe, pranë shtatores së

Komandantit Legjendar Adem Jashari, pastaj në varrezat e Familjes së Komandantit Adem Jashari, si dhe në Varrezat e Dëshmorëve të komunës sonë, në Kleçkë dhe Malishevë.

Në vazhdim, fjala e Kryetarit të Komunës, z.Isni Kilaj, mbajtur në Akademinë e mbajtur, sot në ora 11, në sallën e Asamblesë Komunale në Malishevë.

“Të nderuar këshilltarë, familje të dëshmoreve, veteran të UÇK-së, përfaqësues të institucioneve e të KFO-it ,zonja dhe zotërinj; sot është dita e dëshmoreve dhe ne jemi tubuar në këtë akademi për të nderuar dhe kujtuar heronjtë, dëshmorët dhe martirët tanë të cilët dhanë jetën për idealet e tyre dhe të popullit shqiptare për liri. Kjo ditë, sot, shënon datën kur Adem Jashari bashkë me babën Shaban, vëllaun Hamzen dhe gjithë familjen e tij u sakrifikua në një rezistencë të jashtëzakonshme me forcat serbe e cila do të ishte shembull unik i luftës, rezistencës dhe sakrificës në botë. Bota s’ka dëgjuar për një ngjarje të njëjtë. Populli në Kosovë mbeti i



shtanguar, bashkëluftëtarët e tij morën krahë dhe fluturuan -jeta nuk kishte me kuptim, lufta duhej bërë, Komandanti ishte shndërruar në legjendë, ai kishte dhënë shembullin me vetëdije të plotë se si duhej dashur atdheu, si fitohej liria e cila ishte detyra e çdo shqiptari para atdheut.

Rënia e Komandantit legjendar, tashmë, mobilizoi masat e popullit dhe futi në gjak të çdo shqiptari gatishmërinë për luftë dhe sakrificë. Mijëra djem dhe vasha nga e gjithë Kosova ia mësyn Prekazit legjendar dhe Drenicës. Lufta kishte filluar, UÇK-ja ishte shndërruar në një ushtri të popullit.

Malisheva me kohë, edhe para rënies së Adem Jasharit, kishte filluar të organizohej në celula të UÇK-së, por lufta në Prekaz do të mobilizonte mijëra vullnetarë të cilët kush me ndihma e kush me armë do ti drejtoheshin Drenicës. Malisheva do nxirrte nga gjiri i saj dy Njësite të fuqishme të luftës që do të shndërroheshin në Brigada me mbi 2500 luftëtarë. Këto Brigada do të i jepnin lirisë së Kosovës 70 dëshmorë në tri luftëra, 360 martire dhe 60 të zhdukur. Por ato shënuan qindra beteja të suksesshme të cilat e mundën armikun ushtarak, që ishte më i fuqishëm ushtarakisht, por moralisht më të dobët dhe të pamotivuar për luftë, sepse ishin në tokë të huaj, ishin pushtues.

Sot ne kujtojmë të gjithë të rënë për lirin e Kosovës dhe të trojeve etnike që nga dëshmori i parë në Malishevë, Imer Krasniqi, Ibrahim Mazreku, Hamdi Berisha, Habib Berisha, Jahir Mazreku, Gani Paçarizi, Xhevë Krasniqi, Afrim Krasniqi, Agim Elshani, Beqir Gashi e Hazir Kryeziu, Kujtim Krasniqi e Hilmi Hoti, Visari e Labinoti, Mentori e dhjetëra të tjerë heronj të Kosovës nga Komuna e Malishevës.

Liria jonë nuk ishte e pakushtueshme. Ajo na kushtoi me më shumë se 1500 dëshmorë (heronj) dhe mbi 11000 të tjerë të vrarë e të zhdukur gjatë luftës. Por është çmim i cili na e solli lirin për të cilën kishin luftuar mijëra breza gjatë shekujve. Më 17 shkurt 2008



Parlamenti i Kosovës i dalë nga zgjedhjet e popullit, shpalli Kosovën e lirë dhe të pavarur, pas 10 viteve qeverisjeje nga UNIMK-u, ku sot Kosova njihet nga 65 shtetet më të fuqishme të botës dhe e cila ka marrë një rrugë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, e cila do të na sjell edhe Bashkimin Kombëtar në Evropën e popujve të bashkuar. Sot Kosova po ndërtohet e zbkurohet me shkolla të bukura e moderne, me rrugë të gjera e autostrada, me ujësjellës në fshatra e qytete, me pallate të bukura e jetë më të mirë, fëmijët tanë po rriten në liri pa friken për armikun, me perspektive të ndritshme e të sigurt.

Ne të gjallët përjetë e mot do të përkulemi para altarit të dëshmorëve, veprës së tyre, gjakut të derdhur për lirin tonë. Ata krijuan pavdekësinë, për të gjallët janë vendi i nderimeve dhe i përkuljes.

Brezat që do të vijnë, nxënësit në shkolla do të mësojnë për luftën e tyre, poetët do të thurin vargje, rapsodët këngë kreshnike, ata e shkruan historinë me forcën e pushkës.

Lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit.”

Shënimi i Epopesë, ka qenë dinjitoz dhe i organizuar mirë

Malishevë, 8 mars

Në mbledhjen e radhës së Këshillit të drejtorëve, kryetari i komunës, z.Isni Kilaj, e ka vlerësuar lartë organizimet dhe mbarëvajtjen e shënimit të “Epopeja e UÇK”-së, duke thënë se ka qenë shënim dinjitoz dhe i organizuar mirë.

Në këtë mbledhje kryetari Kilaj, ka kërkuar nga drejtorët e drejtorive, që të vazhdojnë të jenë pjesë aktive në mbledhjet e asamblesë komunale, si dhe nga drejtoria e shërbimeve publike, ka kërkuar që të harmonizohet rregullorja për menaxhimin e mbeturinave.

Drejtori i Drejtorisë së Inspektoratit, Besim Dobruna, ka njoftuar se inspektorët, kanë filluar aksionin për ndëshkimin e bizneseve, që nuk kanë respektuar ligjin, në rastin konkret mos pagesës së taksave të obligueshme, dhe si rezultat, do të ju jepet vërejtja e fundit për disa nga bizneset dhe nëse nuk i përgjigjen kësaj vërejtje, do të pasojë mbyllja e aktivitetit të tyre.

Kurse Drejtori i Drejtorisë për Emergjencë dhe Siguri, Halit Zogaj, ka njoftuar për nevojën e ndryshimit të emërimit të drejtorisë, nga Emergjencë dhe Siguri, në Drejtorinë Komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim, pasi ky emërtim është i rregulluar me ligj.

Po ashtu drejtori Zogaj, ka paraqitur nevojën e kyçjes dhe angazhimit të kësaj drejtorie në projektin për eliminimin e rriqrave dhe parandalimin e epidemisë së etheve hemorragjike dhe ka kërkuar që kjo të bëhet në koordinim me drejtorinë e shëndetësisë.

Nën organizimin e Komunës

Shënohet Dita e Gruas

Malishevë, 8 mars

Nën organizimin e koordinatores së Njesisë Komunale për te Drejtat e Njeriut, Vera Bytyçi, është shënuar 8 marsi Dita Ndërkombëtare e Gruas, në të cilin krahas femrave të punësuar në institucionet lokale dhe shkolla, kanë marrë pjesë edhe zyrtarë udhëheqës të KK të Malishevës.

Zonjusha Bytyçi, këtë ditë e ka vlerësuar si festë që madhëron kuptimin e jetës dhe familjes shqiptare. “Sot është dita ndërkombëtare e pjesës më delikate të shoqërisë, qenies më të brishtë, që i jep jetë jetës, e gruas, e cila kudo që është, sjellë vetëm paqe dhe dashuri”, ka thënë Vera Bytyçi duke kërkuar që shoqëria të kujtohet për gruan edhe ditëve të tjera.

Rexhep Mazreku, nënkryetar i komunës së Malishevës ka shprehur gatishmërinë e institucioneve komunale që të ndihmojnë në ngritjen e femrës së kësaj komune dhe zënien e vendit meritore në shoqëri.

“Në këtë kuptim duhet të punojmë të gjithë për ngritjen arsimore të kësaj pjese të shoqërisë pasi femra e shkolluar, është bazë e modernizimit të shoqërisë”, ka thënë Mazreku.

Për të pranishmet është shtruar edhe një drekë.

Kryetari Kilaj njihet me problemet gjimnazistëve

Malishevë, 10 mars

Në një takim të mbajtur sot me kryetarët e klasave në gjimnazin “Abdyl Frashëri, kryetari i komunës, z.Isni Kilaj, është njoftuar drejtpërdrejt nga nxënësit me problemet e tyre në shkollë, me kushtet e mësimnxënies dhe përditshmërinë e tyre në shkollë.



Ndër problemet kryesore që nxënësit kanë shfaqur, ishin mungesa e hapësirës, fondi i pamjaftueshëm i literaturës në bibliotekën e shkollës, mungesa e internetit në bibliotekë, mungesa e ambienteve për aktivitete të lira, vështirësitë në udhëtim për disa nxënës, mungesa

kabineteve, papastërtia e tualeteve dhe të tjera.

Për të gjitha këto, kryetari Kilaj, ju ka premtuar gjimnazistëve, zgjidhjen e problemeve, të cilat janë kompetencë e komunës, përderisa menaxhimi i buxhetit nga vet shkollat, që pritet të bëhet shpejt, e ka parë si mundësia më e mirë për përmirësimin e kushteve në shkollë.

“Kohë pas kohe, do ta pasurojmë fondin e bibliotekës së shkollës, përderisa në bibliotekë brenda disa ditëve do të keni qasje në internet, pasi kjo është punë e kryer”, ju ka premtuar kryetari Kilaj, gjimnazistëve.

Ndërsa për çështjen e hapësirës dhe numri të madh të nxënësve në klasa, Kilaj i ka sqaruar nxënësit, se është bërë për shkak të përfshirjes së të gjithë nxënësve në mësim dhe që asnjë nxënës të mos mbetet jashtë procesit mësimor.

Ndërtimi i Qendrës së Kompetencës, do të zvogëloj numrin e nxënësve në këtë gjimnaz, përderisa ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës dhe Pallatit të Sportit, do të krijoj edhe hapësirën për zhvillimin e aktiviteteve të lira, ndërsa pastërtia në ambientet e shkollës, dëmtimi i xhamave apo inventarit, është çështje e menaxhimit të brendshëm të shkollës.

Komuna nënshkroi memorandumin për mbrojtjen e fëmijëve në punë

Malishevë, 10 mars

Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, ka nënshkruar sot memorandumin e mirëkuptimit me Institutin për Politika Sociale në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, gjegjësisht me drejtorin e saj, Gafur Podvorica, për formimin e Komitetit Lokal për Monitorimin e Punës së Fëmijëve.

Qëllimi i këtij komiteti është mbrojtja e fëmijëve nga punët e rënda, që në shumë raste, detyrohen nga prindërit apo nga krimi i organizuar, që i detyrojnë fëmijët të bëjnë punë, apo ti keqpërdorin fëmijët për përfitime të caktuara, në forma kriminale.

Ky komitet ka për qëllim zyrtarizimin e Procesit të Monitorimit të Punës së Fëmijëve në Komunë, si një bazë strategjike drejt Parandalimit dhe Eliminimit të Punës së





Fëmijëve si dhe Krijimin e strukturave lokale për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Ky komitet është pjesë e strategjisë së Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në rolin udhëheqës të Komitetit Kosovar për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve, i themeluar me vendimin 5/166 të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës.

Si çdo të enjte Kilaj ka vazhduar me pritjen e palëve

Malishevë, 11 mars

Edhe gjatë ditës së sotme, si çdo të enjte, Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj ka vazhduar me pritjen e palëve (qytetarëve), për ti dëgjuar drejtpërdrejt hallet dhe telashet që ata kanë dhe në disa raste, varësisht prej mundësive dhe kompetencave, ju ka ofruar ndihmën e komunës.

Gjatë ditës së sotme kryetari Kilaj, ka pritur rreth 30 palë nga ora 10 deri në ora 12, ndërsa kjo formë e komunikimit me qytetar, do të vazhdoj edhe në të ardhmen.

Të përgatitet raporti vjetor financiar

Malishevë, 15 mars

Në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, e mbajtur sot dhe e udhëhequr nga Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, është kërkuar përgatitja e raportit financiar, për vitin e kaluar.

Në këtë mbledhje të janë diskutuar për punët e drejtorive, ndërsa nga drejtori për shëndetësi, ka dalë propozimi për një marrëveshje të mundshme mes pronarëve të barnatoreve private, që veprojnë në Malishevë, në mënyrë që ky shërbim të jetë 24 orë në shërbim të qytetarëve.

Ndërsa, masat e javës së kaluar, për bizneset, që të cilat nuk i kanë shlyer obligimet komunale për taksat vjetore, sipas drejtorit për ekonomi, buxhet dhe financa, ato masa kanë pasur efekt pozitiv.



Kryetari Kilaj ka vazhduar takimet me qytetar

Malishevë, 18 mars

Si çdo të enjte edhe sot, kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka vazhduar me pritjen e palëve, gjegjësisht takimin me qytetar prej orës 10 deri në 12, me ç'rast ka pritur afro 30 palë, individ por edhe grupe.

Kryetari Kilaj, përmes këtyre takime njihet më për së afërmi me hallet dhe problemet e qytetareve.

Në disa nga rastet e sotme, kryetari ka ofruar ndihmën apo mbështetjen e komunës, varësisht prej kompetencave dhe mundësive që ka komuna.

Nuk kanë munguar as urimet për mandatin e tij të dytë si kryetar komune, nga persona të cilët për arsye të ndryshme edhe përkundër dëshirës, si janë shprehur ata, nuk kanë mundur ti shprehin urimet e tyre.

Takimet me qytetar do të vazhdojnë çdo të enjte prej orës 10 deri në 12.

U mbajt mbledhja e dytë e KPF-së

Malishevë, 18 mars

Në mbledhjen e dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa - KPF, të mbajtur sot dhe të kryesuar nga kryesuesi i KK të Malishevës, z. Ragip Begaj, janë shqyrtuar dhe janë dërguar katër rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë Komunale, për procedim të mëtutjeshëm.

Në këtë mbledhje janë shqyrtuar propozimi për ndryshimin e Rregullores për kompensimin e tokës private me tokë publike dhe kompensimi me mjete financiare në procedurë të shpronësimit dhe ndërrimit, si dhe është shqyrtuar dhe rekomanduar për procedim të mëtutjeshëm edhe Rregullorja mbi mbrojtjen nga zjarri në territorin e Komunës së Malishevës. Gjithashtu për në mbledhjen e ardhshme të asamblesë është rekomanduar që të diskutohet edhe ndryshimi i Rregullores mbi arsimin në Komunën e Malishevës.

Nga ky takim kanë pasuar si rekomandime për asamble dhe dy propozime për emërtim të rrugëve, njëra në Malishevë dhe një në Guncat.

Nuk do të lejohen ndërtimet pa leje në Malishevë

Malishevë, 22 mars

Në mbledhjen e sotme të rregullt të Qeverisë Komunale, të mbajtur sot, Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, ka kërkuar nga shërbimet përgjegjëse, në veçanti nga inspektorët komunal, që të mos lejojnë asnjë ndërtim pa leje në qytet dhe më gjerë dhe çdo ndërtim i nisur pa leje përkatëse, të ndërpritet nga ana e inspektorit të ndërtimit.

Kryetari Kilaj, është i vendosur në ruajtjen e imazhit të qytetit dhe ndërtimit të tij, sipas standardeve dhe planit ekzistues urban, dhe si rezultat i kësaj, komuna e Malishevës dhe vet qyteti, vazhdon të mbetet me më së paku ndërtime pa leje.

Ndërsa një pikë tjetër e diskutuar nga ana e kryetarit, është edhe vazhdimi i aksionit ndaj bizneseve të mëdha dhe të vogla, për vjeljen e taksave komunale, për bizneset të cilat nuk e kanë shlyer këtë obligim ligjor që kanë ndaj komunës.

Aksioni i javëve të kaluara për vjeljen e taksave komunale nga ana e bizneseve është treguar shumë i suksesshëm, ndërsa inspektorët komunal, do të vazhdojnë me këtë aksion.

Kompletohet stafi i Qendrës së Kompetencës

Malishevë, 22 mars

Sot edhe zyrtarisht është kompletuar stafi i Qendrës së Kompetencës në Malishevë, pas mbajtjes së intervistave edhe për mësimdhënësit dhe kuadrit tjetër administrativ dhe shërbyesve, ndërsa menaxhmenti ishte kompletuar më herët.



Për 36 mësimdhënës në Qendrën e Kompetencës, kishin aplikuar 185 kandidat, ku sipas drejtorit të drejtorisë së arsimit, Isuf Morina, në përgjithësi kandidatët kanë treguar përgatitje të lartë.

“Ka qenë një konkurrencë shumë e fortë e kandidatëve potencial. Komisioni është munduar dhe besojnë që kemi arritur ta zgjedhim kuadrin më profesional dhe të përgatitur mirë, pasi konkurrenca ka qenë jashtëzakonisht e fortë dhe kandidatët kanë treguar përgatitje të lartë profesionale”, ka thënë drejtori Isuf Morina.

Me këtë përzgjedhje të menaxhmentit, kuadrin mësimor, atij administrativ dhe shërbyesve civil, sipas drejtorit Morina, është kryer kompletimi i stafit dhe tani do të ecet me hapat tjerë të përgatitjeve për fillimin e mbarë të punës në Qendrën e Kompetencës.

USAID-i, komuna dhe hidroregjioni

Nënshkruajnë marrëveshjen për ndërtimin e ujësjellësit për fshatrat Turjakë e Burim

Malishevë, 25 mars

Kryetari i komunës së Malishevës, z.Insi Kilaj, sot ka nënshkruar një marrëveshje me USAID-in dhe Hidroregjionin Jugor, për ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit për fshatrat Burim dhe Turjakë. Për këtë projekt në vlerë prej 331 512 euro, komuna do të investoj



170 mijë euro, USAID-i 150 mijë dhe pjesën tjetër Hidroregjioni Jugor. Nënshkruesit e kësaj marrëveshje ishin kryetari Isni Kilaj, përfaqësuesi i USAID-it, Ëilliam Martt, ai i CDF-së, Muharrem Hajredini dhe drejtoresha e Hidroregjionit Jugor, Ajshe Cikaqi.

Qëllim i këtij projekti është furnizimi me ujë të

pijes për këto dy fshatra, ndërsa projekti është një shtojcë e atij të Gurbardhit, nga i cili do të furnizohen një pjesë e fshatrave të komunës, si dhe do të jetë në harmoni me standardet ndërkombëtare të ujësjellësve.

Me këtë rast, kryetari ka falënderuar USAID-in për këtë investim për qytetarët e Malishevës dhe për bashkëpunimin e mirë që ekziston mes komunës dhe USAID-it.

“Në emër të qytetarëve dhe komunës së Malishevës, ju falënderoj për ndihmën e tuaj, për qytetarët e Malishevës dhe ne ju jemi shumë mirënjohës, Qeverisë dhe popullit amerikan”, tha mes tjerash kryetari i Malishevës, Isni Kilaj, pas nënshkrimit të marrëveshjes.

“Jemi të kënaqur që kemi mundësi ta ndihmojmë shtetin e Kosovës dhe në veçanti komunën e Malishevës, pasi kemi përjetime të veçanta nga kjo komunë dhe bashkëpunim shumë të mirë”, tha Eilliam Martt, përfaqësues i USAID-it.

Kënaqësinë për këtë bashkëpunim dhe arritjen e kësaj marrëveshje e ka shprehur edhe Ajshe Cikaqi, drejtoreshë e kompanisë së ujërave “Hidroregjioni Jugor”.

Nga mbledhja e sotme e kuvendit

Miratohen të gjitha pikat e rendit të ditës

Malishevë, 26 mars

Në mbledhjen e sotme të Asamblesë Komunale në Malishevë, e kryesuar nga kryesuesi Ragip Begaj, janë miratuar të gjitha pikat e rendit të ditës të parapara për sot.

Me shumicë votash është miratuar propozimi i Kryetarit të Komunës, z.Isni Kilaj, për emërtimin e rrugës nga objekti i shkollës së mesme profesionale Qendra e Kompetencës deri tek Palestra Sportive, me emrin e Dëshmorit “Habib Berisha”, si dhe ai i kryesisë së fshatit Ngucat, për emërtimin e rrugëve të fshatit me emrat e dëshmorëve nga ky lokalitet.

Në mbledhjen sotme, këshilltarët komunal, kanë miratuar edhe ndryshimet në katër rregullore, të cilat janë të përshtatura me ligjet në fuqi.

Rregulloret e ndryshuara dhe të miratuara sot, të cilat paraprakisht kanë kaluar në Komitetin për Politikë e Financa (KPF) janë:

- a) Rregullorja për Kodin e mirësjelljes dhe masat disiplinore në shkollat për arsimin fillor dhe të mesëm të ulët;
- b) Rregullorja për Kodin e mirësjelljes dhe masat disiplinore në shkollat për arsimin e mesëm të lart;
- c) Rregullorja për kompensimin e tokës private me tokë publike dhe kompensimin me mjete financiare në procedurë të shpronësimit dhe ndërrimit, dhe
- d) Rregullorja mbi mbrojtjen nga zjarri në territorin e komunës së Malishevës.



Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve

Prilli do të jetë muaj i aksionit për mbrojtje të ambientit

Malishevë, 29 mars

Në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, e ka shpallur muajin prill, si muaj të aksionit për mbrojtje të ambientit në territorin e Malishevës, me ç'rast është kërkuar që gjatë tërë muajit të organizohen aksione për largimin e mbeturinave.

“Me datën 1 Prill, komuna dhe të gjitha institucionet tjera në Malishevë të marrin pjesë në aksionin për pastrimin e ambientit, ndërsa gjatë muajit të organizohen aksione për largimin e mbeturinave, të mbillen drunjt gjelbërues, si dhe brenda këtij muaji të jetë e gatshme për procedim Rregullorja për mirëmbajtjen e pastërtisë në territorin e komunës së Malishevës”, këto janë disa nga çështjet e kërkuara nga kryetari Kilaj.

“Përveç komunës, edhe Policia e Kosovës, institucionet shëndetësore, shkollore dhe të gjitha institucionet tjera, duhet të njoftohen dhe të merren masat për sigurimin e mjeteve të punës, për Ditën e Ambientit, të enjten me 1 Prill”, shtoj më tej z. Kilaj, duke kërkuar nga drejtoritë përkatëse që ti marrin këto masa dhe ti njoftojnë institucionet.

Në mbledhjen e sotme, është diskutuar edhe për vazhdimin e projektit për eliminimin e rriqrave dhe mbrojtjes nga infektimi me ethe hemorragjike, aksion që do ta përfshijë tërë territorin e Malishevës, për spërkatje selektive. Në lidhje me këtë, është formuar edhe një Këshill Mbikëqyrës, ku marrin pjesë, drejtorët e drejtorive komunale për shëndetësi, emergjencë dhe bujqësi, gjegjësisht, Skënder Hoti, Halit Zogaj dhe Sinan Kryeziu.

Ndërrohet komanda LMT-së në Malishevë

Malishevë, 30 mars

Nga sot, në “Shtëpinë fushore” (LMT) të KFOR-it, në Malishevë, përmes një ceremonie zyrtare, është ndërruar komanda e kësaj njësie, nga kontingjenti gjerman dhe tani komandën e ka kontingjenti zviceran.

Në këtë ceremoni, ka marrë pjesë edhe Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, me ç'rast ka shprehur falënderimin për kontributin e kontingjentit gjerman, si pjesë e KFOR-it, në Malishevës, si dhe ju ka dëshiruar mirëseardhje kontingjentit zviceran.

“Gjermania gjatë luftës për çlirimin e Kosovës ishte fuqi primare bashkë me anglezët dhe amerikanët, kurse Zvicra ka prirë në njohjen e pavarësisë së Kosovës”, ka thënë ndër të tjera kryetari Kilaj, në fjalën e tij të mbajtur në këtë ceremoni.

Me këtë rast, komandanti i Brigadës Shumëkombëshe të Jugut, gjenerali Hofmajer, ka vlerësuar lartë bashkëpunimin e qytetarëve dhe komunës me KFOR-in, dhe sipas tij raportet kanë qenë të shkëlqyera.

Ndërsa gjenerali Huber, nga kontingjenti zviceran, ka premtuar se do të punojnë në të mirë të Malishevës dhe se angazhimi i LMT-së zvicerane, do të jetë i madh dhe do të bashkëpunojnë me institucionet dhe qytetarët e Malishevës.

Përkujtohen dhe nderohen martirët e “Masakrës së Burimit”

Malishevë, 31 mars


Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, i shoqëruar nga nënkryetari z. Rexhep Mazreku, kryesuesi i Asamblesë Komunale, z. Ragip Begaj, zyrtarë tjerë komunal dhe këshilltar të KK të Malishevës, kanë bërë sot homazhe, në nderim të 42 martirëve të vrarë në “Masakrën e Burimit”, njëmbëdhjetë vjet më parë.

Në varrezat e martirëve të kësaj masakre, të cilat gjinden në Dragobil, kanë bërë homazhe edhe familjarë dhe të afërm të të vrarëve.

“Masakra e Burimit”, e kryer nga forcat serbe, me 31 mars të vitit 1999, është masakra më e madhe në komunën e Malishevës, ku janë vrarë dhe masakruar 42 qytetar, kryesisht të fshatrave Dragobil dhe Astrazup.

Pas homazheve një delegacion nga komuna dhe familjarë, kanë vizituar edhe vendin ku ka ndodhur ngjarja tek “Vrella e Mëhillit”, në Burim.

Kësaj masakre i ka shpëtuar vetëm Nuredin Morina, nga fshati Astrazup, i cili ishte i radhitur për pushkatim me 42 të vrarët e tjerë.





Nga mbledhja e KPF-së

Katër çështje u rekomanduan për kuvend

Malishevë, 31 mars

Në mbledhjen e sotme të Komitetit për Politikë e Financa- KPF, janë diskutuar katër çështje (si më poshtë), për të cilat më pas janë adresuar si rekomandime për kuvend.

1. Ndërtimi i fushës së futbollit të madh me koncesion;
2. Raportimi i pasqyrave financiare për vitin 2009;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-ndryshimit të Rregullores për orarin e punës të subjekteve afariste në territorin e Komunës së Malishevës, dhe
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-ndryshimit të Rregullores, për Mirëmbajtjen e Pastërtisë në territorin e Komunës së Malishevës, janë katër çështjet për të cilat anëtarët e këtij organi legjislativ kanë diskutuar, dhe më pas kanë vendosur që si rekomandime t'i dërgojnë në kuvend.

Sa u përket kërkesave të tjera nga ana e qytetarëve, KPF, vendosi që me këto të merret në një mbledhje të veçantë.